



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:173490

Datë: 16.09.2024

Numri i dokumentit: 06163572

KPPP.nr. 495/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Florent Zeqiri, në çështjen përmbare të kreditorit N.T.P. “UNIKONZUM”, me numër unik identifikues 810685761 dhe seli në Vushtrri, rr. “Dëshmorët e Kombit”, p.n., me pronar T.M., kundër debitorit IDEAL NNSHT, me numër unik identifikues 600047402 dhe seli në Mitrovicë, me pronar N.J., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Arbër Fazliu, avokat nga Prishtina, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbare P.nr. 931/21, të datës 11.06.2021, të lejuar nga Përmbareuesi Privat Atip Mustafa nga Mitrovica, jashtë seancës me datë 16.09.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET në tërësi si i pa bazuar prapësimi i debitorit IDEAL NNSHT, ndërsa Urdhri Përmbare P.nr. 931/21 i datës 11.06.2021, i lejuar nga Përmbareuesi Privat Atip Mustafa, MBETET NË FUQI.

A r s y e t i m

Përmbareuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit N.T.P. “UNIKONZUM”, me datë 11.06.2021 ka lëshuar urdhrin P.nr. 931/21, duke lejuar përmbareimin në bazë të dokumentit: Faturë nr. 448/20 e datës 10.09.2020, me të cilin e ka urdhëruar debitorin që në emër të borxhit të përcaktuar sipas faturës së lartcekur t’ia paguaj kreditorit shumë prej 6,308.77 EUR (gjashtë mijë e treqind e tetë euro e shtatëdhjetë e shtatë cent) me kamatë ligjore prej 8 %, si dhe shpenzimet e procedurës përmbareimore.

Debitori, përmes përfaqësuesit të autorizuar brenda afatit ligjor ka parashtruar Prapësim duke kundërshtuar në tërësi Urdhrit Përmbare, me arsyetimin se dokumenti në bazë të cilit është lejuar urdhri përmbare nuk është i përshtatshëm për përmbare, ashtu që nuk i plotëson

kriteret sipas dispozitës së nenit 29 të LPP-së. Më tej, ka theksuar se nuk dihet se fatura a është në përputhje me furnizimet e kryera nga kreditori tek debitori, pasi që nga nënshkrimi në faturë nuk dihet se nga kush është pranuar, si dhe nuk është specifikuar periudha brenda së cilës duhet të realizohet pagesa. I ka propozuar gjykatës që të aprovojë prapësimin e debitorit, ndërsa urdhri përmbartimor të refuzohet, si dhe të obligohet kreditori që të kompensojë shpenzimet për përpilimin e prapësimit në shumë prej 156.00 EUR.

Kreditore nuk ka paraqitur përgjigje në prapësim.

Gjykata, pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i pabazuar për shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 29, par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me nën-par.1.3 të këtij neni fatura përcaktohet si një nga dokumentet e besueshme, kurse me nenin 29, par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po qe se në të është treguar kreditore dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbartjes së detyrimit monetar”*, dhe me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbartim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*.

Gjykata në rastin konkret vlerëson se Fatura nr. 448/20 e datës 10.09.2020, i plotëson kushtet për të qenë dokument i besueshëm dhe i përmban të gjitha elementet e kërkuara në përputhje sipas nenit 29 par. 3 të LPP-së, meqenëse në faturë janë treguar palët, përkatësisht kreditore dhe debitori, janë të përshkruara shërbimet të cilat kanë qenë objekt i faturës, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbartje nga ana e debitorit si dhe koha e përmbartjes së këtij detyrimi.

Tutje, Gjykata gjeti se fatura e lartcekur është pranuar në mënyrë të rregullt nga ana e debitorit, fakt ky që vërtetohet nga nënshkrimi i debitorit në faturë, dhe e njëjta i është bashkangjitur propozimit për përmbartim në origjinal, në përputhje me nenin 37 të LPP-së, dhe si e tillë paraqet bazë për lejimin e përmbartimit pasi që është e përshtatshme për përmbartim.

Gjykata pati parasysh pretendimet e debitorit se nuk është kontestues obligimi që debitori ka ndaj kreditorit por që kontestues është afati i pagesës pasi që në faturën mbi bazën e së cilës është lejuar urdhri përmbarim nuk është specifikuar koha kur duhet të kryhet pagesa dhe se kjo ka mbetur të arrihet sipas marrëveshjes së palëve, por që këtë pretendim, gjykata e vlerësoi si të paqëndrueshëm nisur nga fakti që afati i pagesës së faturës nr. 448/20 është data 10.09.2020, ndërsa fakti se kjo datë përkon me datën e lëshimit të faturës, nuk paraqet bazë për anulimin e urdhrin përmbarimor pasi që debitori, me pranimin e faturës pa asnjë kundërshtim, është pajtuar edhe me afatin e pagesës.

Si përfundim, gjykata gjeti se nuk ekzistojnë asnjë nga shkaqet e parashikuara me nenin 71 të LPP-së mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbarimit, ndërsa në kuptim të nenit 73 të LPP-së, lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Nga arsyet e paraqitura më lart dhe duke u bazuar në nenin 73 par të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 495/24, datë 16.09.2024

Gjyqtari
Florent Zeqiri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.